

UDHËZIM
Nr.348, datë 27.5.2009

PËR PROCEDURAT DHE DETYRAT QË DUHET TË ZBATOJNË PREFEKTËT DHE KRYETARËT E KOMUNAVE PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË UDHËTIMIT PËR ZGJEDHËSIT PA PASAPORTË, TË CILËVE U DUHET TË UDHËTOJNË NGA ZONAT E LARGËTA PËR TË APLIKUAR PËR LETËRNJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e “Kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve”, ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.417, datë 22.4.2009 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për zgjedhësit pa pasaportë, të cilëve u duhet të udhëtojnë nga zonat e largëta për të aplikuar për letërnjoftim”,

UDHËZOJ:

1. Kryetarët e komunave të përfshira në listën bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr.417, datë 22.4.2009 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për zgjedhësit pa pasaportë, të cilëve u duhet të udhëtojnë nga zonat e largëta për të aplikuar për letërnjoftim” të evidentojnë listën me emrat e shtetasve pa pasaportë dhe që banojnë në fshatra me mbi 5 km larg qendrës së aplikimit për çdo fshat.

2. Në fund të çdo muaji kryetarët e komunave të dërgojnë në prefekturë listën e personave të trajtuar dhe shumën përkatëse.

3. Pas dorëzimit të listave dhe shumave përkatëse nga kryetarët e komunave, prefektët bëjnë vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur dhe në bazë të këtij dokumentacioni (tarifa e paguar dhe lloji i mjetit të transportit, sipas zonës përkatëse), paraqesin kërkesën pranë Ministrisë së Brendshme për shtesë fondi, të shoqëruar me relacion të hollësishëm.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Politikave Financiare, pas verifikimit të dokumentacionit, përgatisin kërkesën për rialokim fondesh në Ministrinë e Financës.

5. Pas çeljes së fondit nga Ministria e Financës dhe njoftimit nga Ministria e Brendshme, prefektët autorizojnë drejtuesit e njësive vendore për përdorimin e fondit të miratuar.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen prefektët, kryetarët e njësive të përfshira në listën bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr.417, datë 22.4.2009 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për zgjedhësit pa pasaportë, të cilëve u duhet të udhëtojnë nga zona të largëta për të aplikuar për letërnjoftim, “Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Politikave Financiare.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani